



KONFERENCA
Diaspora Flet

PROMOVIMI I PROJEKTEVE TË
DIASPORËS LOKALE NË
QYTETET/RAJONET E
PËRZGJEDHURA NË VENDET AMË.

17-20 MAJ 2018

VIZIONI

Vizion ynë i punës është që të promovojë projekte të diasporës lokale në qytete dhe rajone të përzgjedhura në vendet amë , në mënyrë që të krijohet një urë bashkëpunimi mes shqiptarëve që jetojnë jashtë kufijve të vendeve armëtarë dhe bashkëkombësve tanë në atdhe.

OBJEKTIVAT TONA

1. Krijimin e një ure të suksesshme bashkëpunimi ndërmjet shqiptarëve në diasporë dhe atyre që jetojnë në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, dhe Mal të Zi;
2. Realizimin dhe promovimin e shkëmbimeve socio-ekonomike, arsimore, shkencore dhe kulturore për të lidhur diasporën me vendin e tyre;
3. Ngritja e një strategjie pune për bashkëpunim, legjitimitet ligjor, strukturën e financimit, dhe qëndrueshmërinë e programeve për të siguruar realizmin e qëllimeve tona afat shkurtër dhe afatgjatë;
4. Promovimi i gjuhës dhe kulturës shqiptare përmes teknologjisë duke siguruar që forma jonë kryesore e komunikimit të jetë përmes gjuhës shqipe;
5. Krijimi i programeve konkrete e të realizueshme gjatë gjithë vitit, për shkëmbime përvojash individuale, shkëmbim të aftësive dhe njohurive në përmirësimin e zhvillimit të përgjithshëm të rajonit si dhe për të forcuar identitetin tonë kombëtar, pavarësisht nga kufijtë gjeografik.

HISTORIKU

Grupi ynë i punës është i përbërë nga profesionistë të diasporës, shumica e të cilëve i përkasin gjeneratës së parë dhe të dytë . Ne kemi shërbyer si udhëheqës në komunitetet tona të diasporës duke promovuar kulturën shqiptare në të gjithë Evropën dhe Shtetet e Bashkuara. Ne bashkërisht kemi diskutuar se cilat janë mënyrat më të mira për të angazhuar diasporat lokale me anë të, gjuhës identifikuese, promovimit kulturor, arsimimit, dhe fushave profesionale të zhvillimit, ku emigrantët mund të kontribuojnë me sukses dhe të krijojnë lidhje me të gjithë rajonet. Në prill të vitit 2015 nga Qendra e Harvardit për Zhvillim Ndërkombëtar realizoi Raportin "Diaspora shqiptaro-amerikane" një Ky raport analizoi grupe të komuniteteve të diasporës shqiptare që jetojnë në Boston, Nju Jork, dhe Uashington DC, ku 59% prej tyre ishin nga Shqipëria, 20% nga Kosova, 5% nga Mali i Zi, dhe 4% nga Maqedonia. Sipas statistikave të këtij raporti ndër personat e intervistuar:

- 82% kanë përfunduar një diplomë Bachelor,
- 34% kanë një diplomë masteri, dhe
- 12% kanë një PhD
- 38% e këtyre individëve janë në moshën rreth të 30-tat, 30% në tek të 20-at, dhe 21 % tyre janë në moshën rreth të 40-ave.
- në mënyrë të veçantë në lidhje me interesin e tyre për të punuar për diasporë, 51% kanë deklaruar se janë aktiv në komunitetin e tyre shqiptar e vullnetarizmi është forma më popullore e përfshirjes së tyre.
- në lidhje me tipologjinë e programeve kryesore që diaspora duhet të angazhohet,, 81% e të Intervistuarve janë shprehur për programe në fushën e arsimit, 76% për zhvillimin profesional, 63% në favor të ndihmave humanitare, 54% përmes zhvillimit të biznesit dhe të tregtisë, si dhe 47% nëpërmjet investimeve.

Edhe pse raporti i mësipërm ka marrë në studim vetën një grup të reduktuar të diasporës shqiptare ka të ngjarë që rezultatet pasqyrojnë përbërjen e përgjithshme e saj. Duke marrë parasysh këtë fakt, është e rëndësishme të theksohet se mbi 76% e individëve të intervistuar janë të interesuar për programe në angazhime të shkëmbimit profesional e arsimor, do të thotë se ka potencial për të krijuar një urë të fortë lidhëse mes diasporës dhe atyre që jetojnë në mëmëdhe me anë të financimeve të duhura, strukturave, dhe bashkëpunimit mes diasporës organizatave joqeveritare, bizneseve dhe qeverisë..

METODOLOGJIA

Grupi ynë i punës ka punuar bashkarisht që prej muajit shtator të 2017 e deri më sot, duke dhënë kontributin individual në realizimin e këtij plani. Ky plan është një plan i përgjithshëm i veprimit, që do të jenë më i detajuar pasi grupi t ë takohet në konferencë ku ka mundësi për të parë dhe kuptuar nevojat e qyteteve dhe qytezave lokale. Ky plan do të ndahet në tri faza:

Faza 1: Kuptimi dhe Identifikimi

Faza 2: Strategjia dhe Krijimi

Faza 3: Realizmi dhe Ruajtja

Faza 1: Hapi i parë që do të ndërmarrim është të kuptojmë nevojat e komunitetit në Shqipëri, Kosovë dhe Mal të Zi për të përgatitur bazën e punës tonë.

Cila është infrastruktura?

Çila është përbërja e diasporës?

Cilat janë statistikat?

Cilat janë aftësitë aktuale të zhvillimit profesional nëpërmjet diasporës dhe cilat janë vështirësitë për t'i arritur ato?

Cilat nga organizatat jo-qeveritare, agjencitë qeveritare, apo bizneset private mund të jenë partnerë të dobishme? Etj ,.

- Identifikimi i fushave të bashkëpunimit dhe krijimi i lidhjeve formale me ministritë e diasporës në Shqipëri dhe Kosovë
- Zhvillimi i një udhërrëfyes (roadmap) për komunat dhe rajonet në vendet amtare, krijimi i një strategjie bashkëpunimi, identifikimi i nevojave dhe mënyrave për realizimin me sukses të projekte të ndryshme të diasporës.
- Identifikimi i fushave kryesore e territoret më të përshtatshme për realizimin e projekteve afat të gjatë
- Përcaktimi i partnerëve kyç ndërkombëtarë që do të shërbejnë si bashkëpunëtorët afatgjatë në realizimin e projekteve tona

Faza 2: pasi kemi krijuar një panoramë me informacione rreth diasporës dhe popullsisë lokale, hapi i dytë i yni ka të bëjë me përzgjedhjen e projekteve dhe koordinimin e punës me qeverinë, organizatat e tjera, bizneset, etj. Ne duhet të krijojmë një strukturë pune të përshtatshme për suksesin e projekteve tona si dhe gjetjen e burimeve të duhura për të realizuar këtë.

- Krijimi i një Qendre Koordinimi për Diasporën, ku projektet mund të prezantohen duke u seleksionuar ato që janë më të mira. Qendra do të ketë përgjegjësinë për të ndihmuar realizimin e projekteve të caktuara e për gjetjen e financimeve të duhura, sponsorët e duhura, etj., përmes orientimeve online të këshillit konsultativ
- Krijimi i një regjistri të të dhënash për të gjitha projektet e diasporës me qëllim të transparencës
- Krijimi i një task force për të mbikëqyrur të gjitha projektet dhe evidentuar nëse janë duke funksionuar si duhet, nëse respektojnë kohën, dhe nëse janë të suksesshme.

Faza 3: hapi i tretë është nisja e punës me të gjithë informacionin e akumuluar deri në këtë pikë. Krijimi i një strukture të koordinuar pune me nisjen e një programi pilot. Koha ideale për nisjen e këtij projekti duhet të jetë në vjeshtë të vitit 2018.

Pas nisjes së programit pilot në vjeshtën e vitit 2018, ne duhet të monitorojmë ecurinë e tij dhe të krijojmë një qëndrueshmëri në punën tonë për të siguruar që programet e ardhshme të kalojnë fazën pilot.

SI?

Programet e mëposhtme duhet të zbatohen duke marrë parasysh situatën aktuale të diasporës, burimet, dhe strukturat e nevojshme.

Në vijim janë programet e ndryshme dhe idetë që grupi ynë ka propozuar.

Duke u bazuar dhe në rezultatet e konferencës së majit 2018, në vjeshtë të vitit 2018 ne do të nisim punën me një ose dy nga idetë e mëposhtme .

1. Projektet që promovojnë sipërmarrësit e rinj (deri në moshën 35vjec) nga diaspora për t'u rikthyer në vendin armëtar, projekte për organizimin e seminareve të përbashkëta, apo të grupeve të punës me individë drejtues në fusha të ngjashme, apo në studime kërkimore, ose dhe për të drejtuar një projekt lokal që do të kontribuoj në zhvillimin ekonomik dhe mundësitë e punësimit të komunitetin në nevojë.
2. Projekte të shumta për të promovuar kulturën dhe gjuhën tonë në komunitetet e diasporës në mbarë botën, në bashkëpunim me grupet e diasporës lokale në mënyrë që të rritet ndërgjegjësimi i përkatësisë së identitetit tonë kombëtar.
3. Projektet që promovojnë turizmin.
 - a. Me financimin e duhur, ne mund të krijojmë udhëtime turistike për komunitetin e diasporës së lindur jashtë vendit. Ne mund te organizojmë udhëtime për anëtarët e rinj të diasporës drejt Shqipërisë, Kosovës, Malit të Zi me qëllim rritjen e vetëdijes së përkatësisë së vendit amë, kulturës dhe gjuhës kombëtar.
4. Projekte që kanë për qëllim promovimin e gjuhës shqipe në komunitetin e diasporë, sidomos për brezin dytë, brezin e tretë, dhe kështu me radhë.
 - . Koordinimi i punës për vendosjen e bashkëpunimit me organizatat e diasporës për të krijuar një program për mësimin e gjuhës shqipe. Kjo mund të realizohet përmes një shkollë online, një program të shkëmbimit të mësimdhënësve, etj . Ky projekt do të kërkonte një regjistër të dhënash të të gjitha organizatave shqiptare për të shkëmbyer idetë e eksperiencat e përbashkëta për të punuar së bashku.
 - a. Krijimi i një platforme shqipfolëse që eliminon kufijtë dhe vendos lidhje direkte me diasporën. Ideja është që kjo platformë të jetë një urë lidhëse mes shqiptarëve në vendin e origjinës dhe atyre në diasporë, me qëllim të avancimit të mësimin të gjuhës shqipe në mënyrë më të natyrshme sesa përmes një strukturë të klasës. Platforma duhet të kërkoj regjistrimin e personave që duan ta përdorin për të zhvilluar një bisedë apo për zgjedhjen e një teme (muzikë, histori, letërsi, artit, etj). Grupi i punës mund të kontribuoj duke ftuar sa më shumë pjesëmarrës në këtë platformë, fakt që do të ndikoj në rritjen e projektit.
5. Projektet që synojnë vullnetarizmit.
 - . Ky tip projekt është shumë i realizueshëm duke marrë parasysh kostot e ulëta të tij. Mendoni se si shumë të rinj (sidomos në shkollë të mesme apo universitet) paguajnë nga xhepi për të pasur mundësi vullnetare për të shtuar eksperiencat e kurrikulat e tyre. Ne mund të punojnë me bizneset lokale apo Nonprofits dhe për të krijuar programe vullnetare ku anëtarë të diasporës shqiptare, sidomos ata të lindur jashtë vendit, mund të dhurojnë kohën e tyre për të përmirësuar vendin e tyre amë.

KUR?

Pasi të takohemi në maj 2018 në konferencën e Germin, ne do të marrim një kuptim më të mirë të punës që grupet e tjera janë duke bërë, duke parë ku idetë tona mbivendosen, ku mund të bashkëpunojmë me ta, mund të shkëmbejmë idetë me bizneset apo organizatat jo-qeveritare dhe të kuptojmë se çfarë komunitetet kanë më nevojë.

Grupi ynë dëshiron të krijoj dhe të zhvilloj të paktën dy ose tre projekte të veçanta që mund të nisnin në vjeshtë 2018.

ANËTARËT E GRUPIT

Franceska Gjorgja, ShBA – Kryesuese e grupit

Albana Kepi, Itali

Arton Bashli, Itali

Hazbije Dizdorevi, Suedi

Mimoza Ferraj, ShBA

Mirela Mezani, Zvicër

Megi Mass, Gjermani

Aida Kosta, Mbretëria e Bashkuar

Marika Mamillo, ShBA

Fotin Shehu, Greqi

Laura Selmani, Itali

Rinol Alaj, ShBA

Alma Ford, ShBA

Peter Christoper, ShBA

Urban Sadiku, Kosovë

Naim Sadiku, Austri

Naim Azizi, Gjermani

Migjen Kajtazi, Zvicër